



23-05-2017



Prishtinë/Priština, rr./ul. Agim Ramadani tel. +381 (0) 38 551 679; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Prishtinë / Priština
Nr./Br. 1137-2017

Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, 106 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 5 të Rregullës Zgjedhore nr. 06/2013 Qendra e Numërimit dhe Rezultateve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 23.06.2017, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Rekomandimit të Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve

- I. Miratohet rekomandimi i Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës të datës 11 qershor 2017, për vendvotimet si vijon:
- II.1811E/01D, 2125B/02D, 2815B/01D, të rinumërohen
- III.Vendvotimi: 2802B/01R të procedohet i rregullt
- IV.Vendvotimi: 2802B/04D dhe për të gjitha rastet e krahasuara me Listën Përfundimtare të Votuesve- LVP me rubrikën numër pesë (5) të Formularëve të Përputhjes së Rezultateve –së-FPR.
- V. Pas procesit të rinumërim, për vendvotimet si në pikën II dhe IV të këtij vendim, rritet niveli i tolerancës deri në tetë (8), në mënyrë që të procedohen si të rregullta.
- VI. Obligohet Sekretariati për zbatimin e këtij vendimi.
- VII. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Duke u bazuar në rekomandimin e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve (QNR) të datës 23.06.2017, është konstatuar se pas kontrollit të bazës së të dhënave, përfshirë edhe krahasimin e numërimit të nënshkrimeve në Listën Përfundimtare të Votuesve (LPV) me rubrikën numër pesë (5) në Formularin e Përputhjes së Rezultateve, ka rezultuar se katër (4) LPV nuk kanë mundur të procedohen si të rregullta, për shkak të mospërputhjes së numrit të nënshkrimeve në LPV dhe rubrikën 5 në FPR.

Vendvotimin si në pikën III të këtij vendimi, pas hetimit nga QNR-ja rezulton se numri i fletëvotimeve në kutin e votimit përputhet me numrin e votuesve që kanë votuar, andaj u vendos si në pikën III të këtij vendimi.

Vendvotimi nga pika IV e këtij vendimi u propozuan nga QNR-ja se të gjitha rastet e krahasuara me LPV dhe me rubrikën 5 të FPR-së, të rritet niveli i tolerancës në deri në tetë (8), në mënyrë që të procedohen të rregullta. Andaj, KQZ-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, 23.06.2017

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete Daka

